



Data: 19.04.2019

Ref.: 628/190

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 68-të, të mbajtur më 10 prill 2019, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.489/19H, datë 25.03.2019 e Kolegjit "Fama", si e bazuar.
2. Anulohet pika 1.2 e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.307/19D, datë 25.02.2019 me te cilën është tërhequr akreditimi i programit të studimit, Ekonomi, BA, 180 ECTS.
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.307/19D, datë 22.05.2019 mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

KSHC me vendim Nr.307/19D, datë 25.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për ri/akreditimin e programeve të studimit si në vijim: Administrim Biznesi, MBA, 120 ECTS; Ekonomi, BA 180 ECTS; Infermieri, BSc 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS; Mami, BSc 180 ECTS; Psikologji, BA 180 ECTS, dhe Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja (Validim).

Kolegjit "Fama", brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.307/19D, datë 25.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 25.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Kolegjit "Fama" ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programin e studimit, Ekonomi, BA, 180 ECTS, të cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.307/19D, datë 25.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë për këtë program të studimit, janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 68-të të KSHC-së, të mbajtur me 10 prill 2019, dhe në fund, KSHC erdhi në përfundim që ankesa është pjesërisht e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e studimit,

Ekonomi, BA, 180 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pjesën tjetër të ankesës për programet e studimit: : Administrim Biznesi, MBA, 120 ECTS; Ekonomi, BA 180 ECTS; Infermieri, BSc 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS; Mami, BSc 180 ECTS; Psikologji, BA 180 ECTS, dhe Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja (Validim), KSHC vendosi që këtë çështje ta referoj për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave, bazuar në pikën pesë të nenit 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe inicimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegjit "Fama";
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.

G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

